

Raportimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme në kuadër të procesit të post liberalizimit të vizave për muajin janar 2015.

1. Bashkëpunimi operacional mes autoriteteve përkatëse të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Shteteve Anëtare të BE-së dhe agjencive të BE-së.

- *Numri i operacioneve të kthimit gjatë periudhës raportuese;*

Muaji janar 2015

- a) Operacione të kthimit në PKK, Rinas – 7 operacione Charter me 151 shtetas nga Franca 81 shtetas nga Anglia 37 shtetas, nga Belgjika 13, nga Gjermania 20.
- b) Operacione të kthimit në PKK, Kapshticë - 86 operacione me 258 shtetas të deportuar nga Greqia;
- c) Operacione të kthimit në PKK, Qafë Botë - 14 operacione me 211 shtetas të deportuar nga Greqia;
- d) Operacione të kthimit në PKK, Hani i Hotit - 3 operacione me 4 shtetas të deportuar nga Mali i Zi;
- e) Operacione të kthimit në PKK, Qafë Thanë - 13 operacione me 28 shtetas të deportuar nga Maqedonia;
- f) Operacione të kthimit në PKK, Bllatë - 5 operacione me 5 shtetas të deportuar nga Maqedonia;
- g) Operacione të kthimit në PKK, Kakavijë – 14 operacione me 415 shtetas të deportuar nga Greqia;
- h) Qendra e Mbyllur për të Huajt - 3 operacione me 21 shtetas me destinacion Greqinë nga PKK Kakavijë 19 shtetas, nga PKK Kapshticë 1 shtetas dhe nga PKK Rinas 1 shtetas.

- *Numri i operacioneve të përbashkëta të kontrollit të kufijve dhe i patrullimeve të përbashkëta të kufijve gjatë periudhës raportuese;*

I) Operacione të Përbashkëta;

Vazhdon normalisht puna e përbashkët në Pikën e Përbashkët të Kalimit të Kufirit Muriqan - Sukobinë me Policinë e Malit të Zi.

II) Patrullime të Përbashkëta;

Janë zhvilluar takimet rajonale dhe lokale sipas planifikimit dhe sipas situatave në kuadrin e bashkëpunimit ndërkufitar me shtetet fqinjë, si më poshtë:

Me Italinë;

Nga ana e shërbimeve të policisë kufitare në Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin në Durrës, gjatë muajit janar 2015 janë kryer 8 takime të përbashkëta me Guardia di Finanzia në lidhje me shkëmbimin e informacioneve me qëllim mbajtjen nën kontroll të vijës bregdetare si dhe evidentimin në kohë reale për goditjen e trafikimeve të ndryshme që mund të bëhen në kufirin blu.

Me Greqinë;

Në datat 7, 21 dhe 29 janar 2015, në ambientet e Stacionit të Policisë Kufitare dhe Migracionit Kakavijë, janë zhvilluar takime lokale me palën Greke, me përfaqësues të

Raportimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme në kuadër të procesit të post liberalizimit të vizave për muajin janar 2015.

policisë kufitare të të dy vendeve. Në këto takime është diskutuar për problemin e kthimeve INAD të shtetasve shqiptarë në hyrje për në Greqi pa i pajisur ata me dokumente prapësimi, aktin e refuzimit të hyrjes. Gjithashtu, është diskutuar në lidhje me fenomenin e imigrantëve të paligjshëm që vijnë nga vendet e treta nëpërmjet kufirit të gjelbër nga Greqia për në Shqipëri si dhe për problemin që është bërë ritual kohët e fundit ku shtetasit shqiptarë kthehen nga pala greke me pretendimin se në pasaportë kanë një vulë fallso të vendosur vite më parë, ndërkohë që këta shtetas pas vulës së pretenduar fallso, kanë hyrë e dalë disa herë në shtetin Grek.

Në datën 9, 16, 23 dhe 30 janar 2015, në ambientet e Stacionit të Policisë Kufitare dhe Migracionit Çarshovë, janë zhvilluar takime me përfaqësues të policisë kufitare të të dy vendeve. Në këto takime është diskutuar mbi bashkëpunimin ndërmjet dy Pikave të Kalimit Kufitar për zbatimin e ligjit, dhënien e informacionit në kohë reale për rritjen e sigurisë në të dy anët e kufirit, për rastet e shtetasve shqiptarë që kthehen nga policia greke në kategorinë INAD pa u dhënë aktin e refuzimit të hyrjes.

Në datën 14.01.2015 në PKK Qafë Botë - Mavromat, është zhvilluar një takim lokal me palën Greke, me përfaqësues të policisë kufitare të të dy vendeve. Në këtë takim është shkëmbyer informacion për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë së kundraligjshme, krimit ndërkufitar, vjedhjeve, kalimeve të paligjshme të kufirit, kontrabandës, dëmtimit të kullotave të banorëve grek në vijën e kufirit, si dhe për marrjen e masave të përbashkëta për lehtësimin e procedurave të kontrollit të shtetasve shqiptarë dhe të huaj.

Gjatë këtij muaji, në Stacionin e Policisë Kufitare dhe Migracionit Kapshticë janë zhvilluar 4 takime lokale, me përfaqësues të policisë kufitare të të dy vendeve. Në këto takime është diskutuar në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet dy Pikave të Kalimit Kufitar për zbatimin e ligjit dhe dhënien e informacionit në kohë reale, për rastet e shtetasve shqiptarë që kthehen nga policia greke në kategorinë INAD pa u dhënë aktin e refuzimit të hyrjes, si dhe për tendencat e shtetasve të vendeve të treta kryesisht sirianë, për të hyrë nga Greqia në Shqipëri nëpërmjet kufirit të gjelbër.

Me Malin e Zi;

Në datën 13.01.2015 në PKK Muriqan Shkodër, është zhvilluar një takim në nivel rajonal mes Policisë Kufitare të Shqipërisë dhe asaj të Malit Zi. Në këtë takim janë bërë analiza të përbashkëta mbi shërbimet e kryera, rezultatet e arritura në koordinimin dhe bashkëpunimin e shërbimeve, evidentimin e drejtimeve të mundshme që mund të përdoren për aktivitete të kundraligjshme nëpërmjet kufirit si dhe planifikimi i shërbimeve të përbashkëta për muajin shkurt 2015.

Janë zhvilluar 9 takime të nivelit lokal në Stacionet e Policisë Kufitare Muriqan, Hani i Hotit, Shkodër. Në këto takime është shkëmbyer informacion për krimin ndërkufitar, janë bërë analiza të përbashkëta javore për koordinimin dhe bashkëpunimin e shërbimeve, janë evidentuar rrugët e mundshme që përdoren për aktivitete të kundraligjshme nëpërmjet kufirit të gjelbër si dhe pikave të kalimit kufitar.

Me Maqedoninë;

Gjatë muajit janar 2015 nga DRKM Korçë, janë zhvilluar 6 takime të përbashkëta lokale me palën Maqedonase, ku 2 takime janë kryer në PKK Qafë Thanë, 2 takime janë kryer në PKK Pogradec dhe 2 takime janë kryer në PKK Pustec. Në këto takime është diskutuar për

Raportimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme në kuadër të procesit të post liberalizimit të vizave për muajin janar 2015.

bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit në kohë reale, forcimin e masave të përbashkëta për parandalimin dhe goditjen e aktivitetit të paligjshëm që tentohet të zhvillohet nëpërmjet kufirit të gjelbër dhe blu si dhe për problemin e prerjes së pyjeve dhe peshkimit të paligjshëm.

Nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Kufitare Dibër, gjatë këtij muaji janë zhvilluar 4 takime të përbashkëta lokale me palën Maqedonase ku është diskutuar, për goditjen e aktiviteteve të kundraligjshme që mund të zhvillohen nëpërmjet kufirit të gjelbër, mbikëqyrjen e vazhdueshme të drejtimeve të mundshme të kalimit të kufirit.

Me Kosovën;

Në datën 19.01.2015 në Kosovë, është zhvilluar një takim në nivel rajonal ku morën pjesë Zv. Ministrat e Brendshëm, Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, drejtues të Policisë së Kufirit, Policisë së Rendit dhe drejtues të Doganave të të dy vendeve. Në këtë takim është diskutuar mbi masat e përbashkëta kundër terrorizmit, bashkëpunimin reciprok dhe masat që duhen marrë në luftën kundër krimit të organizuar dhe goditjen e trafikeve të jashtëligjshme në të dy anët e kufirit.

Gjatë muajit janar në ambientet e Stacioneve të Policisë Kufitare dhe Migracionit të Morinës, Qafë Prushit, Qafë Morinës dhe Shishtavecit, janë zhvilluar 14 takime lokale, ku është diskutuar mbi bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit reciprok për goditjen e kontrabandës nëpërmjet kufirit të gjelbër dhe kontrollin e imtësishëm në PKK në luftën kundër krimit të organizuar.

Gjatë këtij muaji, janë realizuar 52 patrullime të përbashkëta;

- Janë zhvilluar 16 patrullime të përbashkëta me Policinë e Kosovës;
- Janë zhvilluar 22 patrullime të përbashkëta me Policinë e Malit të Zi;
- Janë zhvilluar 9 patrullime të përbashkëta me Policinë e Maqedonisë.
- Janë zhvilluar 5 patrullime të përbashkëta me Guardia di Finanza, Itali.

2 Shkëmbimi i informacionit mes autoriteteve përkatëse të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Shteteve Anëtare të BE-së dhe agjencive të BE-së.

2.1. Treguesit e kthimeve

2.1.1. Kombësia e të kthyerve;

Kombësia e të kthyerve - Shqiptarë

2.1.2. Vendi ku kthehen/vendi që i kthen;

1. Austria	2
2. Belgjika	47
3. Zvicër	78
4. Gjermania	48
5. Danimarka	4
6. Franca	140
7. Finlanda	3

Raportimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme në kuadër të procesit të post liberalizimit të vizave për muajin janar 2015.

8. Mbretëria e Bashkuar	73
9. Greqia	958
10. Italia	78
11. Holanda	4
12. Norvegjia	25
13. Spanja	2
14. Portugalia	2
15. Suedia	12
16. Kroaci	8
17. Irlandë	1
18. Slloveni	2

Totali i të kthyerve është 1487 shtetas.

2.1.3. Arsyet e kthimit

a) Kërkesa për azil të refuzuara	76 raste;
b) Sanksione kriminale	113 raste;
c) Ekstradime	4 raste;
d) Ripranime	146 raste;
e) Kthime vullnetare dhe me forcë	1148 raste.

2.2 Fluksi i rregullt i pasagjerëve

2.2.1. Numri total i udhëtarëve është 937.117 shtetas.

2.2.2. Seksioni kufitar (p.sh PKK Serbo-Hungarez, Kroato-Slloven, Shqiptaro-Italian, FYROM-Serb) që trajton flukset e rregullta të pasagjerëve;

a) Itali	71.447 udhëtarë;
b) Greqi	280.386 udhëtarë;
c) Maqedoni	98.041 udhëtarë;
d) Mali i Zi	139.732 udhëtarë;
e) Kosovë	211.776 udhëtarë;
f) Aeroporti:	135.735 udhëtarë.

2.2.3. Tipi i pasagjerëve (vendas, të huaj);

Shqiptarë	592.080 udhëtarë;
Të huaj	345.037 udhëtarë;

2.3. Kërkesat për pasaportë biometrike

2.3.1. Numri i aplikimeve;
Numri i aplikimeve është 12.828.

2.3.2. Rajoni administrativ ku dorëzohen aplikimet

Raportimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme në kuadër të procesit të post liberalizimit të vizave për muajin janar 2015.

Nr	Rajoni i aplikimit	J 2	J 3	J 4	J 5	Janar 2015	%
1	Berat	261	225	182	166	834	7%
2	Dibër	108	137	102	181	528	4%
3	Durrës	268	288	337	311	1204	9%
4	Elbasan	469	375	394	384	1622	13%
5	Fier	398	378	406	349	1531	12%
6	Gjirokastrë	93	88	89	68	338	3%
7	Korçë	236	172	242	248	898	6%
8	Kukës	74	106	153	158	491	4%
9	Lezhë	218	192	179	176	765	6%
10	Shkodër	172	229	229	262	892	7%
11	Tiranë	399	631	773	791	2594	20%
12	Vlorë	311	224	291	305	1131	9%
Totali		3007	3045	3377	3399	12828	100%

2.4. Pasaporta biometrike të vjedhura e të humbura

2.4.1. Numri i dokumenteve të tilla.

Pasaporta biometrike të humbura janë 700.

3. **Hetime vendase të ndërmjetësuesve të migracionit të parregullt.**

3.1. *Numri i rasteve të zbuluara, të hetuara (administrativisht apo penalisht), të ndjekura penalisht dhe të gjykuara;*

Raste të zbuluara:

- 5 raste të zbuluara për veprën penale “Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve”, me 7 autorë gjithsej, prej të cilëve 7 janë arrestuar në flagrancë.

Në hetim:

- Procedimi penal Nr. 305, viti 2014, në Prokurorinë për Krime të Rënda për veprën penale “Ndihmë për Kalim të Paligjshëm të Kufirit” në ngarkim të 2 personave të dyshuar.
- Procedimi penal Nr. 351, viti 2014, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, për veprën penale “Ndihmë për Kalim të Paligjshëm të Kufirit” në ngarkim të një personi të dyshuar.
- Procedimi penal Nr. 273, viti 2014, në Prokurorinë për Krime të Rënda për veprën penale “Ndihmë për Kalim të Paligjshëm të Kufirit” në ngarkim të 3 personave të dyshuar.

Raportimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme në kuadër të procesit të post liberalizimit të vizave për muajin janar 2015.

- Procedimi penal Nr. 191, viti 2014, në Prokurorinë për Krime të Rënda për veprën penale “Ndihmë për Kalim të Paligjshëm të Kufirit” në ngarkim të 2 personave të dyshuar.
- Procedimi penal Nr. 23, viti 2015, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, për veprën penale “Ndihmë për Kalim të Paligjshëm të Kufirit” në ngarkim të 2 personave të dyshuar.

5. Fushata të reja informimi mbi të drejtat dhe detyrimet e udhëtimit pa viza.

5.1. Shtrirja gjeografike, buxheti, kohë-zgjatja dhe metoda e transmetimit të fushatave të reja të informimit mbi udhëtimin pa viza.

- I) Në Pikat e Kalimit Kufitar të Shqipërisë janë shpërndarë fletëpalosjet sipas grafikut të mëposhtëm:
- a) Totali i mbetur nga muaji dhjetor është 63.741 fletëpalosje;
 - b) Gjatë muajit janar janë shpërndarë 17.512 fletëpalosje;
- II) Gjatë muajit janar 2015, ka vazhduar transmetimi i spoteve publicitare mbi “Ndërgjegjësimin masiv të shtetasve shqiptarë për të respektuar rregullat e hyrjes dhe ato të qëndrimit në vendet e hapësirës Schengen duke eliminuar maksimalisht abuzimin me të drejtën e qarkullimit pa viza në BE”.
- III) Më datë 29 janar 2015 në aeroportin “Nënë Tereza” Rinas, u realizua fluturimi i përbashkët i riatdhesimit të 50 shtetasve shqiptarë e organizuar nga Franca, me pjesëmarrjen e shteteve si Gjermania, Belgjika dhe Danimarka në bashkëpunim me FRONTEx dhe me palën shqiptare. Pala shqiptare siguroi eskortën shoqëruese ku morën pjesë gjithsej 27 persona, përfshirë psikologun dhe përfaqësuesin e Avokatit të Popullit. Për të ndjekur nga afër procedurat e trajtimit të shtetasve të riatdhesuar si dhe infrastrukturën pritëse në këtë aeroport, morën pjesë Zv/Ambasadorja e Gjermanisë në Tiranë dhe Shefi i Sektorit Konsullor në Ambasadën e Gjermanisë në Tiranë.